



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

UDHËZUES PËR POLITIKAT REDAKTORIALE

Përgatitur nga:

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës

Ky udhëzues i politikave redaktoriale është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e mediave nga të gjitha përkatësitë etnike në Kosovë, si dhe me përfaqësuesit e institucioneve që lidhen drejtpërdrejt me këtë çështje dhe këshilltarët ligjorë. Megjithëse ky nuk është një dokument ligjor dhe nuk mbart detyrime ligjore, por këshillohet që të ndiqni dhe pajtoheni me udhëzimet e dhëna. Politika është në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira vendore dhe ndërkombëtare.



Udhëzues për politikat redaktoriale

Ky udhëzues trajton çështjet e etikës, mbrojtjes së të dhënave dhe përfaqësimit të diversitetit në media. Ai përmban katër aspekte kryesore:

- I. Parimet dhe standardet etike, transparenca dhe pavarësia redaktoriale
- II. Mbrojtja e të dhënave dhe privatësisë në media
- III. Përfaqësimi i diversitetit dhe ndjeshmëria sociale
- IV. Mbrojtja e komunitetit dhe shmangia e diskriminimit

I. Parimet dhe standardet etike, transparenca dhe pavarësia redaktoriale

- Mediat kanë obligimin të raportojnë saktë, të verifikojnë informacionin, të shmangin përhapjen e dezinformatave dhe të përfshijnë të gjitha palët e përfshira në një çështje, duke siguruar një raportim të ekuilibruar.
- Si punëdhënës, mediat duhet të respektojnë integritetin e gazetarëve, duke siguruar një mjedis pune të sigurt, pa presion politik apo ekonomik, dhe pa ndikime të jashtme që mund të çenojnë pavarësinë e tyre profesionale.
- Mediat kanë përgjegjësinë të shmangin përdorimin dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes, duke treguar kujdes të veçantë në këtë aspekt.
- Identiteti i viktimave duhet të mbrohet gjatë raportimit, veçanërisht kur bëhet fjalë për të mitur nën 18 vjeç, viktimat të dhunës seksuale, trafikimit apo rasteve të tjera të ndjeshme.
- Duhet të tregohet kujdes i veçantë për privatësinë e grupeve të marginalizuara dhe fëmijëve.
- Mediat janë të obliguara të tregojnë nëse kanë përdorur inteligjencë artificiale në krijimin e përmbajtjes.
- Viktimat e dhunës nuk duhet të riviktimizohen gjatë raportimit.

II. Mbrojtja e të Dhënave dhe Privatësisë në Media

1. Kufizimi i qëllimit të përpunimit të të dhënave

- Mediat duhet të respektojnë parimin e kufizimit të qëllimit të përpunimit të të dhënave personale, duke i përdorur ato vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur, përveç rasteve të arkivimit me interes publik ose për hulumtime shkencore.

2. Parimi i minimizimit dhe saktësisë së të dhënave

- Gjatë raportimit, mediat duhet të përdorin vetëm të dhënat që janë të domosdoshme dhe të sigurojnë saktësinë e tyre.

3. Kufizimi i ruajtjes së të dhënave

- Të dhënat personale duhet të ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme dhe të fshihen ose anonimizohen kur qëllimi është arritur.

4. E drejta për t'u harruar

- Individët kanë të drejtë të kërkojnë fshirjen e të dhënave të tyre nga bazat e të dhënave mediatike, nëse nuk ekziston më interes publik për publikimin e tyre.

5. Pëlqimi i individëve

- Publikimi i fotove, videove apo deklaratave të individëve pa pëlqimin e tyre nuk lejohet, përveç rasteve me interes publik, kur ekziston nevoja për informim dhe me kusht që të mos cënohet dinjiteti i individit.

6. Përpunimi i të dhënave të ndjeshme

- Mediat duhet të tregojnë kujdes të veçantë në publikimin e të dhënave shëndetësore, fotove dhe videove të pacientëve, fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, duke marrë pëlqimin e qartë të subjekteve përkatëse.

7. Përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave

- Mediat duhet të respektojnë të dhënat personale të ndjeshme si etnia, feja, opinionet politike, të dhënat biometrike, shëndeti dhe orientimi seksual, duke siguruar trajtim të kujdesshëm dhe etik.

III. Përfaqësimi i Diversitetit dhe Ndjeshmëria Sociale

Përfaqësimi i Diversitetit dhe Ndjeshmëria Sociale

1. Mbrojtja e fëmijëve në media

- Identiteti i fëmijëve duhet të mbrohet në çdo rast kur raportimi lidhet me çështje që i përfshijnë ata dhe familjet e tyre.

2. Paralajmërimet për përmbajtje të ndjeshme

- Emisionet që trajtojnë dhunën në familje, divorcin, bullizmin etj., duhet të paralajmërojnë shikuesit me etiketime si +12 ose +14.

3. Mosglorifikimi i dhunës dhe krimit

- Mediat nuk duhet të relativizojnë, glorifikojnë apo nxisin aktet kriminale dhe dhunën, duke pasur kujdes në përdorimin e gjuhës dhe përmbajtjes vizuale.

4. Përfaqësimi i drejtë dhe proporcional

- Mediat duhet të sigurojnë një hapësirë të barabartë për të dyja gjinitë, komunitetet joshumicë dhe grupet e cenueshme në përmbajtjen e tyre.

5. Mbrojtja e integritetit njerëzor

- Raportimet nuk duhet të cenojnë dinjitetin njerëzor dhe nuk duhet të përdorin imazhe apo përmbajtje të panevojshme mbi dhunën ndaj grave, komunitetin LGBTQ+, komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, apo statusin social të qytetarëve.

IV. Mbrojtja e Komuniteteve dhe Shmangia e Diskriminimit

1. Shmangia e stereotipizimit dhe etnizimit të lajmeve

- Mediat duhet të shmangin lidhjen e krimeve apo akteve të paligjshme me një grup të caktuar etnik, kulturor ose fetar.
- Raportimi duhet të jetë mbi individët dhe veprimet e tyre, jo mbi përkatësinë e tyre kolektive etnike ose fetare.

2. Respektimi i diversitetit fetar në raportim

- Mediat duhet të përdorin një qasje të ndjeshme dhe neutrale kur raportojnë për komunitetet fetare.
- Duhet shmangur lidhja e praktikave fetare me veprime ekstremiste pa prova të qarta.
- Në raportime që përfshijnë besime fetare, duhet të konsultohen burime të besueshme dhe përfaqësues të komuniteteve për të shmangur keqinterpretimet.

3. Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në media

- Mediat duhet të sigurojnë hapësirë të barabartë për komunitetet joshumicë si serbët e Kosovës, boshnjakët, turqit, goranët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët.
- Gazetarët dhe redaksitë duhet të inkurajohen të përfshijnë perspektivat e komuniteteve joshumicë në temat që kanë të bëjnë me ta, duke mos i trajtuar vetëm si objekte lajmesh negative.
- Programet mediatike duhet të inkurajojnë përfshirjen e gjuhëve të komuniteteve joshumicë në hapësirat informuese, veçanërisht në shërbimet publike të lajmeve.

4. Përdorimi i terminologjisë së përshtatshme dhe neutrale

- Termat dhe përkufizimet për komunitetet duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe praktikat më të mira gazetareske, shmangia e termave poshtërues ose të vjetruara për komunitetet joshumicë si "shk*je", "m*gjup" ose "t*rko".

5. Diversiteti kulturor dhe promovimi i tolerancës në media

- Mediat duhet të promovojnë njohjen dhe përfaqësimin e traditave, kulturës dhe gjuhëve të komuniteteve të ndryshme, duke ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.
- Programet që trajtojnë historinë, kulturën dhe traditat e komuniteteve duhet të bazohen në hulumtime të sakta dhe burime të besueshme për të shmangur keqinterpretimet.
- Debatet mediatike mbi tema etnike dhe kulturore duhet të përfshijnë përfaqësues të komuniteteve për të siguruar një përfaqësim të drejtë.

6. Raportimi mbi konfliktet ndër-etnike dhe ndjeshmëria në trajtimin e çështjeve historike

- Mediat duhet të jenë të kujdesshme në trajtimin e temave që lidhen me tensionet etnike, duke shmangur gjuhën nxitëse ose polarizuese.
- Në raportime mbi historinë e konfliktit, duhet të sigurohet një qasje objektive dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë të gjitha palët e përfshira dhe duke shmangur glorifikimin ose demonizimin e ndonjë grupi.
- Mediat duhet të shmangin narrativat e cilat krijojnë ndarje të qëndrueshme dhe të promovojnë një diskurs pajtues dhe informues.

7. Përdorimi i gjuhëve të komuniteteve në media

- Në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, mediat duhet të ofrojnë përmbajtje në gjuhët e komuniteteve joshumicë në Kosovë.
- Emisionet informative, sidomos në shërbimet publike, duhet të përfshijnë përkthime ose përmbajtje të përshtatura për audiencën e komuniteteve joshumicë.
- Në titrat dhe përkthimet e lajmeve, duhet të përdoren terma të njësuar dhe jo përkthime të pasakta që mund të ndryshojnë kontekstin e informatës.